



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr.66/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e kandidatëve Furkan Erguler dhe Cenet Zubani të subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të parregullsive për ditën e votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.66/2025, të datës 30.12.2025, e parashtruar nga kandidatët Furkan Erguler dhe Cenet Zubani të subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të mbajtura më datë 28.12. 2025.

A r s y e t i m

Me datë 30.12.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ankesa ZP.Anr.66/2025, parashtruar nga Furkan Erguler dhe Cenet Zubani kandidat të subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), në të cilën pretendojnë se gjatë ditës së votimit 28.12.2025, janë evidentuar parregullsitë në Qendrën e Votimit nr. 3201 (vendvotimet 3201/1, 3201/2, 3201/3, 3201/4, 3201/5 dhe 3201/6). Sipas parashtruesit të ankesës parregullsitë kanë të bëjnë me: 1. votim në emër të familjarëve/atërmve (votim i shumëfishtë): Nga deklaratat e mbledhura ekziston dyshimi i bazuar se disa persona kanë ushtruar votën në emër të anëtarëve të familjes/ të tyre. Sipas dëshmive, këto veprime intensifikohen nga ora 15:00 e ditës së votimit. 2. rezultate jashtëzakonisht të dyshimta për dy kandidatë të caktuar: Nga rezultatet e regjistruara, për Mamushën (totali i votave të vlefshme të K DTP-së është 1.941) vërehet se Ergül Mazrek (nr. 4) ka marrë 1.925 vota (rreth 99% të totalit lokal), ndërsa Fatma Taçi (n r. 12) ka marrë 1.818 vota (rreth 93% të totalit lokal). Duhet të dihet se këto kandidatet janë kandidat nga Mamusha, Për më shumë: a)Kutia me numër 3201/1 ka 380 vota të KDTP-së të vlefshme, ndërsa Ergiil Mazrek (nr. 4) ka marr 379 (1 votë më pak se totali), Fatma Taçi (nr. 12) ka marr 306 (74 vota më pak se total i) b)Kutia me numër 3201/2 ka të KDTP-së 354 vota të vlefshme, ndërsa Ergül Mazrek (nr. 4) ka marr 350 (4 vota më pak se totali), Fatma Taçi (nr. 12) ka marr 351 (3 vota më pak se total i). c)Kutia me numër 3201/3 ka të KDTP-së 316 vota të vlefshme, ndërsa Ergiil Mazrek (nr. 4) ka marr 311 (5 vota më pak se totali), Fatma Taçi (nr. 12) ka marr 291 (27 vota më pak se

total i). d)Kutia me numër 3201/4 ka të KDTP-së 299 vota të vlefshme, ndërsa Ergül Mazrek (nr. 4) ka marr 298 (1 votë më pak se totali), Fatma Taçi (nr. 12) ka marr 282 (16 vota më pak se totali). e)Kutia me numër 3201/5 ka të KDTP-së 330 vota të vlefshme, ndërsa Ergül Mazrek (nr. 4) ka marr 327 (3 vota më pak se totali), Fatma Taçi (nr. 12) ka marr 329 (1 votë më pak se totali). f)Kutia me numër 3201/6 ka të KDTP-së 262 vota të vlefshme, ndërsa Ergül Mazrek (nr. 4) ka marr 260 (2 vota më pak se totali), Fatma Taçi (nr. 12) ka marr 259 (3 vota më pak se totali). Në total të 6 kutie të QV të Mamushës, kandidati nga Mamushë Ergül Mazrek (nr. 4) ka marrë 1.925 vota ose 16 vota më pak se totali. Poashtu kandidate nga Mamushë Fatma Taçi (nr. 12) ka marr 1818 vota ose 123 vota më pak se totali.

Megjithatë Kryetari i Partisë Fikrim Damka (nr. 1) ka marr vetëm 274 në total në 6 kutie në QV të Mamushës me numër 3201. Këto përqindjet dhe numrat janë jashtëzakonisht të larta dhe ngrejnë dyshim të arsyeshëm për manipulim. Kjo tregon çartë si indicie të ndërhyrjeve të organizuara gjatë votimit, numërimit dhe rezultatit. Më tej në ankesë pretendohet se parregullësi ka pasur edhe tek përdorimi i identiteteve të personave të vdekur: Është paraqitur listë e personave të vdekur për emrat e të cilëve dyshohet se janë bërë votime. Personat e vdekur: 1. [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR], 3. [REDAKTUAR], 4. [REDAKTUAR]. Poashtu është dyshohet se në emër të personat jo residencial në Kosovë (jashtë Kosovës) janë bërë votime. Disa emërat ku kemi gjetur janë: 1. [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR], 3. [REDAKTUAR],

4. [REDAKTUAR], 5. [REDAKTUAR]. Këto raste kërkojnë verifikim të menjëhershëm nga regjistrat zyrtarë. Pastaj parregullësi në vëzhgime të mundshme nga incizimet e kamerave: Në rast të shqyrtimit të incizimeve të kamerave të sigurisë, ekziston dyshimi i bazuar se zyrtarë të caktuar zgjedhorë që kanë shpërndarë fletëvotimet u kanë dhënë më shumë se një fletëvotim personave të caktuar apo të njohur për ta, duke cenuar drejtpërdrejt parimin e votimit individual dhe të barabartë; kjo rrethanë përbën element të rëndësishëm provues për shkelje serioze të integritetit të procesit të votimit.

5.Shkalla e pazakontë e ulët e votave të pavlefshme: Krahësuar me zgjedhjet e mëparshme, rezulton një rënie e jashtëzakonshme e votave të pavlefshme në Mamushë, çka përforcon dyshimin për përdorim të organizuar/strukturor të votave, Në zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës me datë 9 Shkurt 2025 votat e pavlefshme ka qenë 75 (shihni: statistikën e detajuar nga votimit në vendvotimet e rregullta të KQZ-së). Ndërsa në zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025 në Mamushë ka qenë 156 vota të pavlefshme (118 pavlefshme dhe të zbrazta, 38 fletëvotim të dëmtuara). 6.Dëmtim i transparencës së numërimit përmes ndalesës së kamerave: Raportohet se gjatë fazës së numërimit në VV në ditën e zgjedhjeve kamerat e regjistrimit janë ndaluar/çaktivizuar, veprim që pengon kontrollin e pandërprerë të procesit dhe paraqet indicie të ndërhyrjeve të koordinuara gjatë numërimit. 7.Mos-raportim / presion: Veprimet e mësipërme nuk u parandaluan dhe nuk u raportuan në kohë te autoritetet kompetente, çka ngre dyshime të arsyeshme për presion, frikësim ose ndikim të paligjshëm ndaj personave përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Provat e bashkëngjitura në ankesë janë fotot të marra nga rrjetin social, ku shihet se votueset e Mamushës kanë votuar më shumë se një herë. Kërkojnë nga PZAP që të urdhërojë KQZ-në për dorëzimin dhe sigurimin e kopjeve të incizimeve CCTV për Qendrën e Votimit nr. 3201 (vendvotimet 3201/1—3201/6), me theks të veçantë për periudhën pas orës 15:00, dhe të kryhet analiza e këtyre incizimeve për të verifikuar votimin në emër të të tjerëve dhe ndalesën/çaktivizimin e regjistrimit gjatë numërimit, të bëhet verifikim identifikues mes listave të votuesve dhe regjistrave civilë për personat e paraqitur si të vdekur, të kryhet verifikimi i plotë dhe

krahasimi i nënshkrimeve në listën e votuesve në vendvotim për të identifikuar votimet e dyfishta apo të shumta, duke përfshirë edhe analizimin e mospërputhjeve në xhirimet e kamerave të KQZ-së (veçanërisht lidhur me numrin e votueseve femra), si dëshmi referuese për identifikimin e votimeve të dyshimta, të trajtohen si prova veprimet e konstatuara të ndalimit/çaktivizimit të kamerave si indicie të ndërhyrjeve të organizuara gjatë numërimit, të anulohet procesi i votimit dhe numërimit në QV 3201 në Mamushë.

Në përgjigjen në ankesë të KQZ-së, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovë 2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, gjithashtu ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë,

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuesve se ka pasur parregullsi dhe votim në emër të familjarëve të afërm, votim i shumëfishta dhe rezultate jashtëzakonisht të dyshimta, nuk qëndrojnë sepse, këto parregullsi të pretenduara, nuk janë raportuar nga KKZ-ja në Mamushë, as nga organet e sigurisë në Dhomën Operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve më 28 dhjetor 2025. KQZ pas pranimit të kërkesës së PZAP menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Mamushës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet me datën 31.12.2025, si në vijim (shih bashkangjitur përgjigjen e KKZ në komunën e Mamushë. Sa i përket përgjegjësisë për administrimin e vendvotimit, bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloren Zgjedhore nr. 11/2020 përgjegjësia për administrimin e procesit në vendvotim i takon Këshillit të Vendvotimit (KVV). Roli i institucioneve tjera përkatëse është këshillimor dhe mbikëqyrës, por jo administrues i drejtpërdrejtë i procesit të votimit dhe numërimit. Lidhur me pretendimet për ndërprerjen e energjisë elektrike, nga verifikimet e bëra rezultojnë se në asnjë moment nuk ka pasur ndërprerje të energjisë elektrike në vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve apo fazës së numërimit të votave, Sa i përket regjistrimit të kamerave të sigurisë, edhe në rast të një ndërprerjeje të përkohshme të energjisë elektrike (që nuk ka ndodhur), kjo nuk do të kishte ndikuar në regjistrimin e kamerave, pasi pajisjet janë të pajisura me bateri rezervë, të cilat mundësojnë funksionimin dhe regjistrimin e pandërprerë deri në dy (2) orë pa energji elektrike. Bazuar në të gjitha verifikimet e kryera, pretendimet e paraqitura në ankesë lidhur me ndërprerjen e energjisë elektrike dhe ndaljen e regjistrimit të kamerave nuk qëndrojnë dhe nuk mbështeten në fakte.

Në përfundim, konstatohet se procesi i votimit dhe numërimit të votave është zhvilluar në përputhje me legjislacionin zgjedhor në fuqi dhe nuk janë evidentuar shkelje apo ankesa në ditën e zgjedhjeve që do të ndikojnë në integritetin e procesit zgjedhor". Gjithashtu, lidhur me pretendimet se disa kandidatë kanë më shumë vota se kandidatet tjerë nuk nënkupton se

ka pasur gabime në numërimin e votave në QKN dhe ka pasur shkallë të pazakontë e votave të pavlefshme në krahasim me zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 9 shkurtit 2025, nuk mund të merret për bazë, sepse zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, kanë qenë zgjedhje tjera, me numër tjetër të votuesve, numër të subjekteve politike, kandidateve etj.

Pavarësisht se ankesa e ankuesve i referohet mundësinë së parregullsive në QV dhe QKN gabimeve në numërimin e votave në QKN, ku si rezultat i këtyre gabimeve parregullsive gjoja se janë dëmtuar me vota disa kandidat nuk qëndrojnë sepse nuk janë shpallje e rezultateve përfundimtare, por rezultatet në QKN kanë qenë forma të rezultateve të 2/3 plotësuar në Qendrat Komunale të Numërimit nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit kanë mundur t'i shohin rezultatet e çdo vendvotimi duke shfletuar kopjet e formularëve me qëllim të rritjes së transparencës për procesin zgjedhor.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuesi nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme, të qarta dhe bindes për të vërtetuar se ka pasur parregullsi në vendvotimet e lartcekura nga ankuesit lidhur me shkeljet e supozuara, siç janë librat e votimit, raportet e KKZ-se, Dhomës Operative të KQZ-së, organeve të sigurisë, vëzhguesit etej. KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë, vlerësoj se pretendimet e kandidatëve Furkan Erguler dhe Cenet Zubani të subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Pretendimi ankimor i ankuesit se ka votim në emër të familjarëve/afërmve (votim i shumëfishte), probleme me regjistrim të kamerave të sigurisë, dhe se ka pasë ndërprerje të energjisë elektrike, këto pretendime janë të pa bazuara, pasi që në ankesën e parashtruesit të ankesës nuk ka prova lidhur me këtë pretendim ndërsa nga anëtarët e këshillit të vendvotimit, dhe nga vëzhguesit nuk është konstatuar asnjë vërejtje lidhur me këto pretendime ankimore.

Pretendimi ankimor se janë përdorur identitete të personave të vdekur, këto pretendim janë supozime, dhe njëherit nuk ka asnjë provë materiale të bashkëngjitur në ankesën e ankuesit, ndërsa lidhur me këtë pretendim ankimor ankuesi ka pasë mundësi me atakua listën e votuesve, në periudhën kohore kur është publikuar lista e votuesve, e cila është publikuar disa ditë para ditës së votimit.

Pretendimi ankimor se ka rezultate jashtëzakonisht të dyshimta për dy kandidatë të caktuar, dhe atë se Ergul Mazrek (nr.4) ka marrë 1.925 vota (rreth 99% të totalit lokal), dhe Fatma

Taçi (nr.12) ka marrë 1.818 vota, Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesit e ankesës nuk kanë arritur që të vërtetojnë me prova konkrete, të ligjshme se ka mospërputhje të votave.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesit e ankesës nuk kanë bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime, andaj nuk mund të vërtetohej se ka shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Andaj neni 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesit e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tyre, nuk kanë ofruar dëshmi të karta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 par. 3, 118 par. 1 dhe 119 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.66/2025 datë 31.12..2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.